



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

AD/GJTHPE/.nr.3/23

GJYKATA THEMELORE NË PEJË, me Kryetarin e Gjykatës Armend Berisha, në procedurën disiplinore ndaj gjyqtarit A.M, gjyqtares V.H.R dhe gjyqtarit M.P, duke vepruar sipas ankesës disiplinore të parashtruar nga Y.B, avokat nga Gj., pas shikimit të shkresave dhe vlerësimit të ankesës, jashtë seancës, me datë 14.03.2023, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET ankesa disiplinore e parashtruar nga Y.B, avokat nga Gj., ndaj trupit gjykues të përbërë nga gjyqtari A.M, gjyqtarja V.H.R dhe gjyqtari M.P, **SI E PABAZUAR**.

A r s y e t i m

Me datë 16.02.2023, përmes e-mailit zyrtar, Y.B, avokat nga Gj., në cilësinë e mbrojtësit të pandehurit P.K, nga Gj., në kuptim të nenit 9 par.1 pika 1 të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, ka parashtruar ankesë disiplinore ndaj gjyqtarit A.M, gjyqtares V.H.R dhe gjyqtarit M.P, si trup gjykues në çështjen penale PKR.nr.132/22, për shkelje disiplinore nga neni 5 par.1 nënpar.1.2 të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, me arsyetimin se ish Prokuroria e Qarkut në Pejë tani, Prokuroria Themelore në Pejë ka ngrit Aktakuzë ndaj të mbrojturit të këtu parashtruesit të ankesës dhe dy të bashkëpandehurve të tjerë, ndaj të cilëve ish Gjykata e Qarkut në Pejë, tani Gjykata Themelore në Pejë, ka nxjerrë Aktgjykim me të cilën i mbrojturi i tij është gjykuar me dënim me burgim në kohëzgjatje prej dy (2) viteve ndërsa, dy të bashkëpandehurit e tjerë me dënim me burgim në kohëzgjatje prej një (1) viti. Kundër këtij aktgjykimi, ankesë kanë parashtruar dy të pandehur ndërsa, prokuroria nuk ka parashtruar ankesë dhe sipas ankesave të pandehurve Gjykata e Apelit e ka anuluar Aktgjykimin e Gjykatës së Qarku dhe çështja është kthyer në gjykatën e shkallës së parë në rivendosje. Pas kthimit të çështjes në rivendosje, procedura penale ndaj dy të bashkëpandehurve të tjerë që kanë qenë të mitur është veçuar ndërsa, i mbrojturi i këtu parashtruesit të ankesës është gjykuar me dënim me burgim ndaj të cilit aktgjykim ankesë ka parashtruar e dëmtuara ashtu që, Gjykata e Apelit duke vepruar sipas kësaj ankesë, çështjen e ka kthyer në rigjykim dhe rivendosje. Pas kësaj, trupi gjykues i përbërë nga gjyqtarët A.M – Kryetar i Trupit Gjykues dhe gjyqtarët V.H.R dhe M.P – anëtar të trupit gjykues, kanë shpall aktgjykim dënues ndaj të mbrojturit të këtu parashtruesit të ankesës, duke i shqiptuar dënim me burgim në kohëzgjatje prej pesë (5) vite e gjashtë (6) muaj si dhe të njëjtit, i është shqiptuar masa e paraburgimit pas shpalljes së aktgjykimit, vetëm gojarisht sepse nuk kanë pranuar aktvendim për caktim të paraburgimit. Në këtë drejtim, parashtruesi i ankesës thekson se me shpalljen e këtij aktgjykimi, trupi gjykues me qëllim ka bërë shkelje të ligjit penal përkatësisht, të nenit 395 të KPPRK-së pra, parimit themelor të së drejtës penale - Reformatio in Peius “*Në qoftë se është paraqitur ankesë vetëm në dobi të të akuzuarit, aktgjykimi për sa i përket cilësimit juridik të veprës dhe sanksionit penal nuk mund të ndryshohet në dëm të tij*” ashtu që trupi gjykues duke i pas parasysh këto rrethana, qëllimisht dhe me dashje ka vepruar kundër ligjit penal dhe të pandehurit i ka shqiptuar dënim në kundërshtim me nenin 395 të KPRK-së, pasi nuk është e mundur që gjyqtarët e Departamentit për të Mitur përveç, gjyqtarit M.P që është gjyqtar në

Departamentin Civil, të mos kenë njohuri për dispozitat e lartcekura. Parashtruesi i ankesës ka theksuar se të mbrojturit të tij si pasojë e këtij veprimi të kundërligjshëm të trupit gjykues i janë shkelur garancionet nga nenet 13 dhe 29 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe se në veprimet e trupit gjykues, përveç elementeve të shkeljes disiplinore ka edhe elemente të veprës penale keqpërdorim i detyrës apo autoritetit zyrtar andaj, i propozon Kryetarit të Gjykatës që të ndërmarrë masa disiplinore si dhe të bëjë fletëparaqitje penale meqë, gjyqtarët në fjalë kanë vepruar në mënyrë të kundërligjshme, duke shkelë parimet e Kushtetutës dhe Kodit të Procedurës Penale si dhe duke mos i kryer obligimet ligjore.

Me datë 16.02.2023, në kuptim të nenit 9 par.5 të Ligjit mbi Përgjegjësitë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, Këshilli Gjyqësor i Kosovës është njoftuar për ankesën disiplinore të parashtruar ndaj gjyqtarit A.M, gjyqtarës V.H.R dhe gjyqtarit M.P.

Gjyqtari A.M, në deklaratën e tij të dhënë me shkrim lidhur me pretendimet e parashtruesve të ankesës ka theksuar se pikat e referencës të cekura në ankesë disiplinore nuk përbëjnë shkelje disiplinore por, janë bazë për të parashtruar ankesë kundër aktgjykimit. I njëjti ka theksuar se pjesa e kronologjisë së rrjedhës së procedurës është e saktë por, jo edhe pretendimet e parashtruesit të ankesës për shkelje të të drejtave të akuzuarit, shkelje të ligjit penal dhe keqpërdorim të detyrës dhe autoritetit zyrtar meqë, pretendimet e tilla nuk kanë bazë e as prova që do ta argumentonin një gjë të tillë pasi që në këtë çështje, që nga fillimi nuk ka pasur ankesë në përbërjen e trupit gjykues nga ana e mbrojtjes dhe nuk ka munguar asnjë nga parimet që burojnë nga Kodi i Etikës për Gjyqtar siç janë pavarësia, paanshmëria, barazia, integriteti, profesionalizmi në punë dhe konfidencialiteti. Po ashtu, gjyqtari ka theksuar se është i pabazuar edhe pretendimi për shkelje të Kushtetutës për faktin se të akuzuarit vetëm gojarisht i është caktuar paraburgimi pasi, pikërisht në datën 16.02.2023 kur është shpallë aktgjykimi, njëkohësisht është përpiluar edhe Aktvendimi për caktim të masës së paraburgimit së bashku me Urdhër arrestin (gjë që vërtetohet me datën e ngarkimit të vendimeve në Sistemin Elektronik të Gjykatës) pasi që i njëjti nuk kishte marrë pjesë në shpalljen e aktgjykimit. Lidhur me pretendimet e tjera në ankesë, gjyqtari ka theksuar se më gjerësisht do t'i arsyetoj me rastin e përpilimit të aktgjykimit me shkrim pasi pretendimet e tilla mund të parashtrohen me anë të mjetit juridik – ankesës.

Gjyqtarja V H R, në deklaratën e saj të dhënë me shkrim lidhur me pretendimet e parashtruesit të ankesës ka theksuar se pretendimet e tilla nuk qëndrojnë, për arsye se lënda në fjalë është prishur nga Gjykata e Apelit dy herë për shkak të vendimit mbi dënim dhe nëse mbrojtësi i të pandehurit pretendon për shkelje të ndonjë dispozite ligjore atëherë, i njëjti mund të parashtrojë ankesë në Gjykatën e Apelit, ashtu siç e parashohin dispozitat e Kodit të Procedurës Penale. Si anëtare e trupit gjykues, ka theksuar se ka vepruar në kuadër të kompetencave të saj si gjyqtare dhe bindjes së saj të lirë dhe se dënimi është marrë në kuadër të dispozitave përkatëse ligjore dhe provave të administruara duke theksuar se pretendimet e mbrojtësit mund të jenë shkak i ankesës, por jo edhe i ankesës disiplinore.

Gjyqtari M.P, në deklaratën e tij të dhënë me shkrim lidhur me pretendimet e parashtruesit të ankesës ka theksuar se pretendimet e parashtruesit të ankesës disiplinore janë bazë për parashtrim të ankesës në Gjykatën e Apelit në Prishtinë ndërsa, sa i përket veprimeve të tij si anëtar i trupit gjykues ka sqaruar se ka vepruar brenda kompetencave të tij si gjyqtar dhe sipas bindjes së tij të lirë. Për më tepër, ka sqaruar se veprimet e gjyqtarit për tu konsideruar shkelje disiplinore duhet të kryhen me dashje dhe dashja për të vepruar kundërligjshëm apo për shkelje të detyrës zyrtare, siç pretendon mbrojtja, duhet të argumentohet me prova konkrete. Sa i përket pretendimit të parashtruesit të ankesës se gjyqtari është i caktuar në Departamentin Civil, gjyqtari P. ka sqaruar se që nga data 17.06.2020, është caktuar në Departamentin e Përgjithshëm Penal.

Kryetari i Gjykatës duke vlerësuar ankesën e parashtruar si dhe deklaratat e gjyqtarëve ka gjetur se ankesa disiplinore ndaj gjyqtarit A.M, gjyqtarës V.H.R dhe gjyqtarit M.P, është e pabazuar.

Lidhur me pretendimin e parashtruesit të ankesës disiplinore, avokatit Y.B, se trupi gjykues ka shkelë ligjin penal përkatësisht, ka shkelë dispozitën e nenit 395 të KPPRK-së dhe nenet 13 dhe 29 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, me rastin e shpalljes së aktgjykimit dënues dhe shqiptimit të dënimit me burgim në kohëzgjatje prej pesë (5) vite e gjashtë (6) muaj ndaj të mbrojturit të tij, Kryetari i Gjykatës duke vepruar në cilësinë e autoritet kompetent gjen se pretendimi i tillë është pretendim ankimor për të cilin vendos Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë me kompetencë për të vlerësuar ligjshmërinë dhe saktësinë e vendimmarrjes së gjykatës së shkallës së parë, e cila gjykatë vihet në veprim sipas mjetit të rregullt juridik – ankesës, të parashtruar nga pala e pakënaqur me vendimin e gjykatës, e drejtë kjo e cila mund të shfrytëzohet pasi pala ta pranoj aktgjykimin në formë të shkruar por, assesi nuk hyjnë në domenin e shkeljeve të natyrës disiplinore ashtu siç është përcaktuar me Ligjin për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve.

Ndërsa, sa i përket pretendimit të parashtruesit të ankesës se gjyqtarët e kësaj gjykate duke vepruar në trup gjykues, me dashje dhe qëllimisht kanë vepruar në kundërshtim me ligjin penal dhe i kanë shkelë garantitë kushtetuese, me çka në veprimet e tyre përfshihen elementet e veprës penale keqpërdorim i detyrës apo autoritetit zyrtar, autoriteti kompetent ka gjetur se parashtruesi i kërkesës pretendimet e tilla nuk i ka argumentuar në asnjë mënyrë dhe nuk i ka mbështetur në asnjë provë ashtu që, pohimet se trupi gjykues ka kryer vepër penale mbeten vetëm supozime të pambështetura të parashtruesit të ankesës andaj, në rrethana të tilla Kryetari i Gjykatës vlerësoj se në mungesë të provave që e vërtetojnë se në veprimet e gjyqtarëve A.M, V.H.R dhe M.P, ekzistojnë elementet që e përbëjnë figurën e veprës penale keqpërdorim i detyrës apo autoritetit zyrtar, ashtu siç është përcaktuar me Kodin Penal të Republikës së Kosovës, nuk ka bazë për të parashtruar Kallëzim Penal ndaj të njëjtëve, ashtu siç ka propozuar parashtruesi i ankesës disiplinore në ankesën e tij.

Nga arsyet e theksuara me lartë, konform dispozitave ligjore të nenit 9 par.6 të Ligjit mbi përgjegjësitë disiplinore të gjyqtarëve dhe prokurorëve, dhe nenin 7 par.3 pika 3.2 të Rregullores të Këshillit Gjyqësor të Kosovës nr.05/2019 për Procedurën Disiplinore të Gjyqtarëve u vendos si ne dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË PEJË, AD/GJTHPE/.nr.3/23, me datë 14.03.2023.

**Kryetari i Gjykatës
Armend Berisha**

Vendimi i dorëzohet:

1. *Këshillit Gjyqësor të Kosovës*
2. *Gjyqtarës A.M*
3. *Gjyqtarës V H R*
4. *Gjyqtarit M.P*
5. *Parashtruesit të ankesës – avokat Y.B*